

ERMIRA VOJKA



Audituese e Parë, pranë Departamentit të Kërkimit Shkencor në KLSH.

Lindur në vitin 1980. Diplomuar në Inxhinieri Agrare(2003). Ndjek Fakultetin Ekonomik, dega Financë, viti I II-të, me kohë të pjesshme.

Ka 6 vjet eksperiencë pune, nga të cilat 2 në KLSH.

SFIDAT NË AUDITIMIN E MJEDISIT¹

nga Albana Agolli

Kryeaudituese në Kontrollin e Lartë të Shtetit

dhe

Ermira Vojka

Audituese në Kontrollin e Lartë të Shtetit

Të auditosh çështjet që lidhen me mjedisin, sot kur e gjithë bota është e fokusuar në bio-diversitetin, në ndryshimet klimaterike, ku Institucionet Supreme të Auditimit (SAI-t), auditojnë masat që po merr qeveria për të kontrolluar (për të ulur) ndikimin e ndryshimeve klimaterike, për Kontrollin e Lartë të Shtetit shfaqet si nevojë po aq sa dhe sfidë. Termi “auditimet e mjedisit” është një emërtim i përshtatshëm për të përshkruar një mori aktivitësh në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Në parim auditimet e mjedisit nuk janë ndryshe nga auditimet e tjera që një SAI kryen dhe në këtë kontekst vëmendja e auditimeve të mjedisit duhet të drejtohet; tek zbulimi i aseteve që ka mjedisi, përgjegjësia për vlerën dhe ruajtjen e tyre, përdorimi në të mirën e vendit, pajtueshmëria me ligjet e vendit, me ligjet dhe marrëveshjet ndërkombëtare etj. Nëpërmjet këtyre auditimeve i jepet një

shtysë qeverisë, enteve që auditohen që në çdo projekt të tyre të marrin në konsideratë ndikimin në mjedis qoftë ky ndikim i drejtpërdrejtë apo jo i drejtpërdrejtë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit duke qenë anëtar i Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) është pjesë edhe e Grupit të Punës për Auditimet e Mjedisit. Ky grup është mjaft aktiv ai kryen takime të shpeshta, seminare dhe trajnime disa ditore për probleme të rëndësishme të mjedisit siç janë uji, mbetjet, mbrojtja e pyjeve, pasuritë minerale etj. KLSH përfaqësohet rregullisht nga audituesit e saj në këto takime e trajnime, përfitimet nga të cilat janë të mëdha si në këndvështrimin e problemeve që ngrihen nga kolegët, në gjetjen e mënyrave për zgjidhjen e tyre, në fitimin e njohurive me anë të manualeve të auditimit për çdo çështje mjedisore etj. Konkretisht në takimin e 15 të grupit të punës për mjedisin që u zhvillua para pak kohësh, merrnin pjesë mbi 70 Institucione Supreme të Auditimit. Ky takim ishte mjaft i rëndësishëm për arsye të temave që u diskutuan, të ideve dhe manualeve të reja që ai solli, të përfitimit nga eksperiencia e institucioneve homologe me KLSH. Ky takim vuri theksin në disa çështje të rëndësishme të cilat çdo SAI duhet t'i ketë në vëmendje të punës së tij

KLSH dhe përqasja me ruajtjen e mjedisit

Kontrolli i Lartë i Shtetit në kuadër të objektivave të parashtruara në Planin Strategjik të tij, ka në fokus të veçantë auditimet e mjedisit. Në KLSH është krijuar dhe funksionon një grup për auditimin e administrimit të fondeve shtetërore për mbrojtjen e mjedisit, ruajtja e pasurisë kombëtare. Auditimi i ruajtjes së treguesve ekologjikë në pyje, kullota, gjelbërim, sistemimin ujqor, pastrimi i bregdetit, etj. ka dalë në plan të parë në institucion. Ky grup pune është i ndërgjegjshëm për detyrat që duhet të përmbushë me qëllim kryesor mbrojtjen e mjedisit dhe pasurive të tij, dhe për këtë arsye po implementon

në punën e tij manualet e nxjerra nga Grupi Ndërkombëtar i Punës për Mjedisin.

Eksperiencia ndërkombëtare në ruajtjen e mjedisit

Shpërndarja e eksperiencave dhe njohurive është një nga bazat e asambleve të INTOSAI/ WGEA(Kjo strukture e fundit përfaqëson Grupin e Punës për Auditimin e Mjedisit), ku SAI të ndryshme japin eksperiencat e tyre për tema të ndryshme të auditimit të mjedisit. Çështje të rëndësishme të diskutuara në takimet e punës nga të cilat çdo SAI përpiqet që të nxjerrë përfitime janë:

- Përfundimet e takimit të Rio + 20 për ndryshimet klimaterike, ndikimi i këtij takimi dhe çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm, e ardhmja e çështjeve të mjedisit pas takimit të Rio-s + 20.

- Sinergjizimi midis auditimit të adaptimeve klimaterike dhe auditimit të parandalimit të fatkeqësive ku u theksua rëndësia që kanë auditimet e parandalimit të fatkeqësive natyrore në uljen e kostove dhe dëmeve.

Fatkeqësitë natyrore sjellin humbje të jetëve të njerëzve, dëmtime në bujqësi, dëmtime të ekosistemit etj, dhe si pasojë kanë ndikim direkt dhe domethënës në ekonominë e një vendi dhe në zhvillimin e tij. Sinergjizimi midis uljes së rriskut të fatkeqësive dhe përshtatjes së ndryshimeve klimaterike sipas UNDP bën që çdo dollar i shpenzuar për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore të kursejë shtatë dollarë nga humbjet ekonomike që sjellin këto fatkeqësi.

- Auditimi i problemeve të ujit.

Theksimi i problemeve globale të ujit dhe adresimi i tyre sipas SAI-ve; - mbështetja e qeverisë si përgjigje për zgjidhjen e këtyre problemeve; - analizimi i auditimeve të SAI-ve dhe vlerësimi i punës që kanë bërë për problemet e ujit në vendin e tyre, duke u fokusuar në mënyrë të veçantë në metodat kreative dhe inovative që SAI-t përdorin për të analizuar dhe raportuar prioritetin që kanë çështjet e ujit. Si për shembull: siguria e ujit të pijshëm, cilësia e ujit, planifikimi dhe financimi i strukturës ujore,

implementimi dhe forcimi i ligjeve për ujin, menaxhimi i burimeve ujore, impakti i ndryshimeve klimaterike në ujë, mirëmbajtja e rezervave të ujit që përdoret për përdorim të përditshëm nga korporatat përgjegjëse etj.

- Problemet e mjedisit të lidhura me infrastrukturën

Pyetjet për investimet në infrastrukturë vijnë nga nevoja për të zëvendësuar infrastrukturën ekzistuese dhe infrastrukturën shtesë, për të mbështetur mënyrat e reja të punës dhe të jetës, për rritjen e popullsisë, për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe një kalim të një ekonomie me më pak karbon. Këto pyetje po na drejtojnë në një zhvillim domethënës të infrastrukturës si në vendet e zhvilluara edhe në ato në zhvillim, si në energji, transport, shëndetësi, edukim dhe në sektorin e zvogëlimit të përmytjeve.

Zhvillimi i infrastrukturës përfshin investime me vlerë domethënëse të cilat zgjasin në kohë. Zhvillimi i infrastrukturës së re mund të sjellë përfitime domethënëse përfshirë dhe mundësinë për të ndërtuar në mënyrë të tillë që të përmbushen edhe sfidat që lidhen me ndryshimet klimaterike. Infrastruktura ka ndikim të madh në mjedis si gjatë ndërtimit ashtu edhe gjatë përdorimit të saj dhe si pasojë disa çështje mund të adresohen dhe të zgjidhen nëpërmjet procesit të planifikimit dhe projektimit dhe mund të shikohen mundësitë për të rritur si përfitimet direkte dhe ato indirekte.

- Prezantimi i rezultateve të pyetësorit të 7-të të kryer nga WGEA për auditimet mjedisore që kryen çdo SAI.

E përbashkëta e të gjitha këtyre temave ishte se, auditimet e mjedisit me gjithë vështirësitë e hasura si pasojë e paqartësive të ligjit për veprimtarinë e SAI-t (nuk është shprehur qartë në ligj mandati i SAI-t për auditimet e mjedisit), për mungesë ose pamjaftueshmëri të të dhënave të besueshme, të ekspertëve të jashtëm, etj, ato kanë sjellë një ndikim pozitiv në mjedis dhe janë mirëpritur nga palët e interesuara.

Përfitimet për auditimin e Mjedisit në Shqipëri

Mund të mësohet shumë nga bashkëpunimi midis SAI-ve të ndryshme me apo pa eksperiencë. Mjetet bazë që ne i njohim mirë dhe ato kreative të kombinuara me njëra-tjetrën i japin një ndihmë KLSH, duke i treguar se cilat çështje mund të auditojmë, dhe së fundmi bashkëpunimi midis SAI-ve sjell përmirësime të dukshme në mënyrën se si ne i auditojmë këto çështje.

Detyrat për të ardhmen e afërt

Duhet të pranojmë faktin se përvoja e Shqipërisë në problemet e mjedisit është relativisht e pakët. Ndoshta auditimi i mjedisit në Shqipëri duket si i “tepërt”, por krijimi i një Ministrie për Mjedisin, miratimi i një sërë ligjesh për mjedisin, madje dhe hapja e Fakultetit të Inxhinierisë së Mjedisit në Universitetin Politeknik, Tiranë dhe Universitetin Bujqësor, Tiranë, ku çdo vit diplomohen mbi 100 inxhinierë mjedisi, *do të thotë që edhe vendi ynë bën përpjekje për t’u bashkuar me shtete që kanë vite dhe përvojë në këtë drejtim.*

Pjesëmarrja e KLSH në këto takime pune ndërkombëtare, ka rritur dukshëm performancën e audituesve në lidhje me auditimet e problemeve të mjedisit. Në këtë kontekst KLSH, i del detyrë që të punojë më shumë për njohjen e legjislacionit në lidhje me mjedisin, përfshirja e çështjeve të auditimit të mjedisit në Planin strategjik të tij dhe shtimi i numrit të auditiveve të performancës me temë për mbrojtjen e mjedisit, me qëllim që, me rekomandimet e TIJ, Institucioneve të audituara, të japë ndihmën dhe ndikimin në mjedis. Sinergjizimi midis auditimit të adaptimeve klimaterike dhe auditimit të parandalimit të fatkeqësive, ku spikat rëndësia që kanë auditimet e parandalimit të fatkeqësive natyrore në uljen e kostove dhe dëmeve, është një proces që del në plan të parë.

ⁱ Botuar në gazetën “Ekonomia” datë 28 qershor, 2013.